

FOL

SHKARKIMI I PALIGJSHËM I TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK

PASOJAT NË BUXHETIN E SHTETIT

SHKARKIMI I PALIGJSHËM I TË PUNËSUARVE NË SEKTORIN PUBLIK

PASOJAT NË BUXHETIN E SHTETIT

SHKURT, 2022

Titulli: Shkarkimi i paligjshëm i të punësuarve në sektorin publik – pasojat në buxhetin e shtetit

Autore: Albana Hasani

Kontribuoi: Leunora Azemi

Viti i botimit: SHKURT 2022

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+383 (0)49 131 542



FOL

Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky projekt u financua nga granti i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Opinonet, gjetjet dhe përfundimet e shprehura në këtë raport janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e KFOS-it.

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	3
METODOLOGJIA.....	4
KORNIZA LIGJORE	5
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS.....	6
ANKESAT PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KPMSHC GJATË VITIT 2019.....	7
ANKESAT PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KPMSHC GJATË VITIT 2020	8
ANKESAT PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KPMSHC GJATË PERIUDHËS JANAR – TETOR 2021	8
VENDIMET E KPMSHC-SË NË LIDHJE ME ANKESAT E PARASHTRUARA PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIEVE TË PUNËS.....	10
KONTESTET GJYQËSORE NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET E PUNËS GJATË PERIUDHËS JANAR- TETOR 2021.....	11
VLERA E FITUAR DHE VLERA E HUMBUR E INSTITUCIONEVE NGA KONTESTET GJYQËSORE (TË PËRFUNDUARA ME EPILOG GJATË PERIUDHËS JANAR-TETOR 2021).....	13
INSTITUCIONET ME MË SË SHUMTI KONTESTE TË HUMBURA GJATË PERIUDHËS JANAR-TETOR 2021	8
INSTITUCIONET ME MË SË SHUMTI KONTESTE TË FITUARA GJATË PERIUDHËS JANAR-TETOR 2021.....	10
KONTESTET GJYQËSORE NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET E PUNËS GJATË PERIUDHËS JANAR- TETOR 2021.....	11
MUNGESA E DATABAZAVE PËR LARGIMET / SHKARKIMET E TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE (VËSHTIRËSITË PËR T’U INFORMUAR).....	13

HYRJE

Kontestet nga marrëdhënia e punës ditëve të sotme përbëjnë një ndër problemet më të shpeshta me të cilat shoqëria jonë po përballet. Zhvillimi i hovshëm ekonomik dhe rritja eksponenciale e teknologjisë informative ka ndryshuar balancet në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve. Kësisoj, numri i konflikteve të filluara në ambientet e punës e të cilët po barten në sallat e gjykatave, viteve të fundit ka pësuar rritje rapide. Rrjedhimisht, çdo ditë e më tepër po rritet numri i kërkesave për mbrojtje gjyqësore, pra padive para gjykatave të shtetit për realizimin e të drejtave të pretenduara nga palët në marrëdhënien e punës.

Në parim, në shoqërinë tonë mbizotëron ideja se mosrespektimi i kushteve të kontratave dhe shkeljet e të drejtave nga marrëdhënia e punës janë te pranishme vetëm në sektorin privat. Mirëpo, realiteti i kontesteve të punës i tejkalon edhe margjinat e gjëra të problematikave në sektorin privat. Kontestet e tilla janë te pranishme edhe në sektorin publik, ndonëse sektori publik do të duhej të ishte shembull për praktikën e mira në lidhje me respektimin e plotë të dispozitave ligjore dhe rregulloreve të brendshme, si dhe për ndërprerjet e marrëdhënies të punës së të punësuarve.

Në prapavijë të institucioneve të shumta të administratës shtetërore qëndron shërbimi civil. Shërbimi civil paraqet trupën e personelit të punësuar administrativ të cilët zbatojnë politikat dhe ushtrojnë detyrat ligjore dhe institucionale, në institucionet e pushtetit qendror dhe lokal. Shërbimin civil e përbëjnë nëpunësit civil, të cilët kanë kualifikim dhe aftësi profesionale, dhe të njëjtit marrin pjesë në formulimin, krijimin, monitorimin dhe zbatimin e politikave me qëllim të ushtrimit të autoritetit administrativ publik të institucionit në të cilin punojnë.

Shërbyesit civil gjatë realizimit të detyrave të tyre të punës mund të ndeshen me shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me ligj dhe akte nënligjore. Nga ana tjetër, nëpunësit civil të cilët ushtrimin e detyrave të përcaktuara nuk do ta kryejnë në pajtim me parimet për shërbimin civil apo detyrimeve të tjera ligjore, ata do të i'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre. Nga ky këndvështrim, këto rrethana përbëjnë raste të cilat shtyhen dhe kërkohen mbrojtje institucionale brenda për brenda administratës shtetërore, pra organeve të pavarura shtetërore kompetente për zgjidhjen e kontesteve që burojnë nga shërbimi civil, si dhe instancave gjyqësore.

Shkarkimi i nëpunësve civil nga puna mund të bëhet vetëm për arsyt e përcaktuara me ligj, meqë në të kundërtën mund të konsiderohet i paligjshëm dhe mund të kundërshtohet nga nëpunësit civil në organet kompetente. Rrjedhimisht, moszbatimi dhe shkelja e dispozitave ligjore gjatë shkarkimit apo ndërprerjes së marrëdhënies së punës të të punësuarve, nënkupton pasoja dhe shpenzime të rënda e të panevojshme që i bartë mbi vete buxheti i shtetit. Humbje financiare i shkaktohen buxhetit të shtetit, në rastet kur gjykata e aprovon padinë e paditësve, e anulon vendimin për largim nga puna dhe e detyron të paditurin për kompenzimin e pagave. Krahas këtij kompenzimi, i padituri, përkatësisht institucioni obligohet t'i paguaj paditësit, përkatësisht nëpunësit civil edhe pjesën e kontributit pensional, tatimin, shpenzimet

procedurale, si dhe kamatën e krijuar prej nxjerrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive.

Duke marrë parasysh rastet e shpeshta të shkarkimeve të nëpunësve civil, pra punëtorëve në sektorin publik, me këtë raport mëtohet të shtjellohet përgjithësisht çështja e largimit, përkatësisht shkarkimit të të punësuarve nga shërbimi civil dhe të punësuarve të tjerë në institucionet publike, si dhe çështja e kostos së buxhetit të shtetit si pasojë e këtyre shkarkimeve. Rëndësia e objektit të çështjes merr përmasa serioze meqenëse po preket “kuleta e shtetit”, dhe si e tillë do të duhej që institucionet të jenë më të vëmendshëm në këtë drejtim.

METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij raporti është avokimi dhe tërheqja e vëmendjes së institucioneve përgjegjëse për impaktin dhe pasojat në buxhetin e shtetit me rastin e lirim/ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të të punësuarve në sektorin publik apo çështjeve të tjera në lidhje me punën, kur të njëjtat bëhen duke mos i respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Lëvizja FOL në këtë raport i është referuar të dhënave të marra nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (KPMSHC), statistikave të Ministrisë së Drejtësisë / Avokaturës Shtetërore, si dhe përgjigjeve të të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, të siguruar në bazë të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Në përpunimin e të dhënave të këtij raporti, Lëvizja FOL ka përdorur metodën statistikore dhe metodën analitike. Raporti është kategorizuar në katër pjesë. Në pjesën e parë të raportit janë analizuar në përgjithësi të gjitha dispozitat e Ligjit të Punës sa i përket ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, të Ligjit për Shërbyesit Civil, si dhe të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në pjesën e dytë të raportit është paraqitur numri i ankesave për ndërprerje të marrëdhënieve të punës nga shërbyesit civil në KPMSHC për vitet 2019, 2020 dhe për periudhën janar – tetor 2021, numri i ankesave të paraqitura ndaj institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, dhe numri i vendimeve të marra nga këto institucione gjatë këtyre viteve. Në pjesën tjetër të raportit janë analizuar në mënyrë statistikore vendimet gjyqësore të Gjykatave të Republikës së Kosovës në lidhje me kontestet e punës të sjella gjatë periudhës janar – tetor 2021, në rastet ku Avokatura Shtetërore është paraqitur si përfaqësuese ligjore e institucioneve shtetërore. Numri i vendimeve të sjella, shuma e fituar dhe shuma e humbur nga institucionet shtetërore në këto konteste, si dhe tri institucionet që kanë pasur më shumë konteste të humbura dhe të fituara gjatë kësaj periudhe, janë objekt trajtimi në këtë pjesë të raportit.

Ndërkaq në pjesën e fundit, FOL ka përmbledhur të dhënat e dërguara nga institucionet shtetërore sa i përket numri të të shkarkuarve/liruarve nga puna, si dhe numrin e vendimeve gjyqësore dhe shumave të paguara dhe të fituara nga ana e institucioneve shtetërore në lidhje me këto procese.

Në fund, raporti ofron edhe një sërë rekomandimesh për institucionet relevante, jetësimi i të cilave do të kontribuonte në minimizimin e humbjeve nga buxheti i shtetit.

KORNIZA LIGJORE

Ligji i Punës i Republikës së Kosovës¹ përbën bazën themeltare të rregullimit të raporteve të punës. Në nenin 70 të këtij ligji, rregullohet çështja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga punëdhënësi. Sipas këtij neni, punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur ndërprerja e tillë arsyetohet për shkaqe ekonomike, teknike ose organizative; kur i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës (nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajnojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër).

Gjithashtu, sipas këtij neni, punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës, kur i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjelljeje të keqe e më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; si dhe kur performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim. Të gjitha këto mund të bëhen sapo punëdhënësi ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti.

Sipas nenit 71, punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në këto intervale kohore:

- prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;
- prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike;
- mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

Ndërkaq në nenin 72, vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje. Ky vendim bëhet përfundimtarë në ditën kur i dorëzohet të punësuarit. Punëdhënësi është i obliguar të bëjë pagesën e pagës dhe të ardhurave të tjera, deri në ditën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në Kreun IX të Ligjit të Punës rregullohen procedurat për realizimin e të drejtave të punëtorëve nga marrëdhënia e punës. Sipas nenit 78, i punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda 15 ditëve nga data e pranimit të kërkesës.

Ndërkaq sipas nenit 79 të këtij ligji, çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78, në afatin vijues prej 30 ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.

Sipas nenit 80 të ligjit, nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

[1] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-212 i Punës.

- t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave të tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit;
- nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.

Pra sipas këtyre dispozitave, nëse punëdhënësi padrejtësisht e largon të punësuarin nga puna dhe e njëjta vërtetohet me vendim të gjykatës, atëherë gjykata do ta urdhërojë punëdhënësin që t'ia paguajë të punësuarit kompensimin, shtesat dhe shumën tjera që i takojnë në bazë të ligjit, si dhe ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës. Rrjedhimisht, ndërprerja e kontratës së punës me iniciativën e punëdhënësit duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin e punës. Në të kundërtën, punonjësi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur të drejtat e tij, si dhe ta rikthejë në detyrë dhe t'ia paguajë dëmshpërblim për mungesë të detyruar.

Për nëpunësit që shërbejnë në shërbimin civil, ligjvënësi ka sjellë ligj të veçantë me të cilat do të rregullohet statusi i tyre si dhe marrëdhënia juridike e punës midis nëpunësve civil dhe institucioneve shtetërore. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në maj të vitit 2010, rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale. Sipas dispozitave të këtij ligji, nëpunësi civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit, i cili ka rezultuar me vepër penale, siç është përcaktuar me këtë ligj.²

Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2018 kishte miratuar Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton funksionet, kompetencat, organizimin dhe funksionimin e këtij institucioni.³ Në kuptim të dispozitave të këtij ligji, marrëdhënia e punës së nëpunësve civilë të karrierës mund të ndërpritet në rast të kryerjes së dobët të detyrës. Dy (2) vlerësime vjetore të dobëta, të njëpasnjëshme, të kryerjes së detyrës rezultojnë në ndërprerjen e menjëhershme, e cila vendoset nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucionin në të cilin punon nëpunësi civil, pas rekomandimit nga mbikëqyrësi.⁴

Këshilli është institucion i pavarur kushtetues që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, i cili shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil, mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil, monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Sipas dispozitave të këtij ligji, nëpunësi civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshill, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Nëpunësi civil ka të drejtë që të parashtojë ankesë në Këshill në mënyrë

[2] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/I-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

[3] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 13 / 10 gusht 2018, Prishtinë 35, Ligji nr. 06/I -048 për

[4] Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/I-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 87.

elektronike në pajtim me legjislacionin përkatës për komunikimin elektronik si dhe rregullat e përcaktuara me rregulloren përkatëse për parashtrimin e ankesave në Këshill.

Nëpunësi civil apo kandidati për pranim në shërbimin civil ka të drejtë që të parashtrojë ankesë në Këshill në mënyrë elektronike në pajtim me legjislacionin përkatës për komunikimin elektronik si dhe rregullat e përcaktuara me rregulloren përkatëse për parashtrimin e ankesave në Këshill. Këshilli brenda afatit prej 45 ditësh nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim duke e arsyetuar bazën ligjore dhe faktike të vendimmarrjes.

Sipas nenit 21 të këtij ligji, vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.

Ndërsa kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Ekzekutimi i këtij vendimi nuk ndalohet as me Inicimin e konfliktit administrativ. Në rast të moszbatimit të vendimit të Kryetarit të Këshillit për ndalimin e 50% të pagës mujore, Këshilli brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e kalimit të afatit për zbatim mund të fillojë procedurën e përmbarimit të vendimit në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurën përmbarimore.

Me qëllim të përcaktimit dhe rregullimit më të qartë dhe më të detajuar të të drejtave, përgjegjësive dhe detyrimeve të të punësuarve, në janar të vitit 2015 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës. Palë në këtë marrëveshje janë: përfaqësuesit e punëdhënësve, përfaqësuesit e të punësuarve dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.⁵

[5] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.38 / 18 Qershor 2014, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

4. KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

(Ankesat e pranuarra për ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë vitit 2019, 2020 si dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021)

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPMSHC / Këshill) është një institucion i pavarur për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së menaxhimit në shërbimin civil dhe rregullohet me ligj të veçantë.⁶ Funkcionet e KPMSHC-së janë të përqendruara në shqyrtimin e ankesave të nëpunësve civil dhe aplikuesve për punësim në shërbimin civil të Kosovës, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil dhe vëzhgimin e zgjedhjes së nëpunësve civil te nivelit drejtues dhe niveleve të njëjta në Institucionet e Kosovës. Baza ligjore për funksionimin e Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet nënligjore që implementojnë këto ligje.

Këshilli përbëhet prej 7 anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat 7 vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër. Kryetari i Këshillit zgjidhet me shumicë të votave nga radhët e anëtarëve të Këshillit, me mandat 2 vjeçar, dhe me mundësi rizgjedhjeje. Kryetari i Këshillit udhëheq, përfaqëson, dhe përgjigjet për veprimtarinë e KPMSHC-së.⁷

Nëpunësi civil, apo kandidati për praninë në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në KPMSHC, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.⁸

Këshilli brenda afatit prej 45 ditëve nga dita e pranimit të ankesës, nxjerr vendim duke e arsyetuar bazën ligjore dhe faktike të vendimmarrjes. Përrjashtimisht, në rastet kur natyra e lëndës është specifike, Kryetari i Këshillit ka të drejtë të shtyjë afatin e vendimmarrjes edhe për 10 ditë pune.⁹

Gjatë vitit 2019, 2020 dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në lidhje me ndërprerjen e paligjshme të marrëdhënies së punës të shërbyesve civil ndaj institucioneve të nivelit qendror dhe lokal ishin parashtruar gjithsej 128 ankesa.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të parashtruara nga nëpunësit civil për ndërprerje të marrëdhënies së punës të parashtruara gjatë vitit 2019, 2020 dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHC).

[6] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Shërbyesit Civil, neni 9.

[7] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 8 dhe 11.

[8] Po aty, neni 16.

[9] Po aty, neni 17.

PERIUDHA KOHORE	NUMRI I ANKESAVE NË KPMSHC PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS:
Viti 2019	53 ankesa
Viti 2020	26 ankesa
Janar - Tetor 2021	49 ankesa

Tabela 1.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale për ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë vitit 2019, 2020 dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021.


Në tekstin e mëposhtëm janë paraqitur të dhënat e detajuara në lidhje me ankesat e paraqitura në KPMSHC gjatë këtyre viteve, numrin e ankesave të parashtruara ndaj institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe numrin e ankesave të aprovuara, të refuzuara, të hedhura poshtë etj..

4.1 ANKESAT PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KPMSHC GJATË VITIT 2019

Nga gjithsej 784 ankesa të parashtruara pranë KPMSHC-së në vitin 2019 në lidhje me çështje të ndryshme, 53 ankesa apo 6.76 % e tyre ishin parashtruar kundër vendimeve të institucioneve për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënies së punës.

Nga këto 53 ankesa, 17 prej tyre ishin kundër vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, ndërsa 36 ankesa ishin kundër vendimeve të institucioneve të administratës lokale.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në formë grafike numri i ankesave të paraqitura ndaj institucioneve të nivelit lokal dhe të atij qendror për vitin 2019.



Grafikoni 1.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale për ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë vitit 2019.

Kjo nënkupton se në vitin 2019 dukshëm më shumë persona kanë parashtruar ankesa ndaj vendimeve për ndërprerje të punës ndaj institucioneve të administratës lokale, se ndaj atyre të administratës qendrore.

Nga ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore në vitin 2019, numri më i madh i ankesave ishin parashtruar ndaj vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë (5 ankesa), ndaj vendimeve të Ministrisë së Infrastrukturës (2 ankesa), si dhe ndaj vendimeve të Administratës Tatimore të Kosovës (2 ankesa).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të dërguara nga ish të punësuarit në lidhje me vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionet e administratës qendrore gjatë vitit 2019.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE:	NUMRI I ANKESAVE PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS GJATË VITIT 2019:
Ministria e Shëndetësisë	5 ankesa
Ministria e Infrastrukturës	2 ankesa
Administrata Tatimore e Kosovës	2 ankesa
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1 ankesë
Ministria e Punëve të Jashtme	1 ankesë
Ministria e Financave	1 ankesë
Agjencia Pyjore e Kosovës	1 ankesë
Agjencia e Statistikave të Kosovës	1 ankesë
Agjencia Kosovare e Privatizimit	1 ankesë
Qendra e Studentëve të Universitetit të Prishtinës	1 ankesë
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	1 ankesë
Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike	1 ankesë

Tabela 2.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, organeve të pavarura dhe subjekteve tjera gjatë vitit 2019 për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Ndërkaq në ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të institucioneve të administratës lokale gjatë vitit 2019, numri më i madh i tyre ishin parashtruar ndaj vendimeve të Komunës së Prishtinës (7 ankesa), pastaj ndaj vendimeve të Komunës së Kllokotit dhe të Gjilanit (nga 4 ankesa), si dhe ndaj vendimeve të Komunës së Rahovecit (3 ankesa).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të dërguara në KPMSHC nga ish të punësuarit në lidhje me vendimet për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucionet e administratës lokale gjatë vitit 2019.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS LOKALE:	NUMRI I ANKESAVE PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS GJATË VITIT 2019:
Komuna e Prizrenit	1 ankesë
Komuna e Mitrovicës	2 ankesa
Komuna e Kamenicës	1 ankesë
Komuna e Obiliqit	2 ankesa
Komuna e Gjilanit	4 ankesa
Komuna e Klllokotit	4 ankesa
Komuna e Gjakovës	1 ankesë
Komuna e Rahovecit	3 ankesa
Komuna e Vitisë	1 ankesë
Komuna e Kaçanikut	1 ankesë
Komuna e Vushtrrisë	1 ankesë
Komuna e Shtërpcës	2 ankesa

Tabela 3.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës lokale gjatë vitit 2019 për ndërprerje të marrëdhënies së punës.


Sa i përket vendimeve të KPMSHC-së, duhet të theksohet se gjatë tërë vitit 2019 deri në tetor të vitit 2020 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka qenë jofunksional, andaj gjatë kësaj periudhe nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me ankesat e parashtruara.

4.2 ANKESAT PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KPMSHC GJATË VITIT 2020

Nga gjithsej 444 ankesat e parashtruara pranë Këshillit në vitin 2020, 5.86% e tyre apo 26 ankesa janë dërguar nga ish të punësuarit ndaj vendimeve për ndërprerje të marrëdhënieve të punës ndaj institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

Prej këtyre ankesave, 21 ishin parashtruar ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, ndërsa vetëm 5 ndaj vendimeve të administratës lokale. Kjo nënkupton se, ndryshe nga viti 2019, gjatë këtij viti numri i ankesave të parashtruara ndaj vendimeve të administratës qendrore ishte dukshëm më i lartë.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në formë grafike numri i ankesave të paraqitura ndaj institucioneve të nivelit lokal dhe të atij qendror për vitin 2020.



Grafikoni 2.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale për ndërprerje të marrëdhënieve të punës gjatë vitit 2020.

Nga ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, numri më i madh i ankesave ishin parashtruar ndaj vendimeve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (4 ankesa), ndaj vendimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (3 ankesa), si dhe ndaj vendimeve të Ministrisë së Infrastrukturës (2 ankesa).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të paraqitura ndaj institucioneve të administratës qendrore gjatë vitit 2020.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE:	NUMRI I ANKESAVE PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS GJATË VITIT 2020:
Ministria e Punëve të Brendshme	1 ankesë
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	4 ankesa
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	3 ankesa
Ministria e Infrastrukturës	2 ankesë
Ministria e Drejtësisë	1 ankesë
Administrata Tatimore e Kosovës	1 ankesë
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	1 ankesë
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	1 ankesë
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1 ankesë
Autoriteti i Aviacionit Civil	1 ankesë
Agjencia Pyjore e Kosovës	1 ankesë
Shërbimi Korrektues i Kosovës	1 ankesë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1 ankesë
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1 ankesë
Agjencia e Statistikave të Kosovës	1 ankesë

Tabela 4.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, organeve të pavarura dhe subjekteve tjera gjatë vitit 2020 për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Ndërsa sa i përket ankesave të parashtruara ndaj vendimeve të nivelit lokal, nga 5 ankesat e parashtruara gjithsej, 2 ankesa ishin parashtruar ndaj vendimeve të Komunës së Prishtinës, ndërsa ndaj Komunës së Prizrenit, Pejës dhe Kaçanikut nga 1 ankesë.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS LOKALE:	NUMRI I ANKESAVE PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS GJATË VITIT 2020:
Komuna e Prishtinës	2 ankesa
Komuna e Prizrenit	1 ankesë
Komuna e Pejës	1 ankesë
Komuna e Kaçanikut	1 ankesë

Tabela 5.


Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës lokale gjatë vitit 2020 për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

4.3 ANKESAT PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS NË KPMSHC GJATË PERIUDHËS JANAR – TETOR 2021

Gjatë periudhës janar - tetor 2021 në KPMSHC janë parashtruar gjithsej 49 ankesa për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënies së punës ndaj të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, duke përfshirë institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

Nga 49 ankesat e parashtruara, 31 prej tyre janë parashtruar ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore, ndërsa 18 ankesa ndaj vendimeve të institucioneve të administratës lokale. Pra ndryshe nga viti 2019 ku pjesa më e madhe e ankesave ishin parashtruar ndaj vendimeve të nivelit lokal, në vitin 2020 dhe në periudhën janar-tetor 2021, pjesa më e madhe e ankesave ishin ndaj vendimeve të administratës qendrore.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike numri i ankesave të parashtruara ndaj institucioneve të nivelit qendror dhe të atij lokal.



Grafikoni 3.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore dhe lokale për ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë vitit 2019.

Nga ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore gjatë periudhës janar - tetor 2021, sikurse në vitin 2020, numri më i madh i ankesave ishin parashtruar ndaj vendimeve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ndërmarrësisë (4 ankesa), ndaj vendimeve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (3 ankesa) dhe ndaj vendimeve të Shërbimit Korrektues të Kosovës (3 ankesa).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të paraqitura ndaj institucioneve të administratës qendrore gjatë periudhës janar – tetor 2021.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE:	NUMRI I ANKESAVE PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS GJATË VITIT 2020:
Agjencia e Statistikave të Kosovës	1 ankesë
Shërbimi Korrektues i Kosovës	2 ankesa
Shërbimi Sprovues i Kosovës	1 ankesë
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	2 ankesa
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1 ankesë
Administrata Tatimore e Kosovës	2 ankesa
Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë	4 ankesa
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1 ankesë
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	1 ankesë
Presidenca e Kosovës	1 ankesë
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës	1 ankesë
Ministria e Infrastrukturës	1 ankesë
Ministria e Punëve të Brendshme	2 ankesa
Ministria e Shëndetësisë	2 ankesa
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1 ankesë
Inspektorati i Punës	1 ankesë
Ministria e Drejtësisë	1 ankesë
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	3 ankesa
Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike	1 ankesë
Këshilli Prokurorial i Kosovës	1 ankesë

Tabela 6.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të administratës qendrore organeve të pavarura dhe subjekteve tjera gjatë periudhës janar – tetor 2021 për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Ndërkaq nga ankesat e parashtruara në lidhje me vendimet e institucioneve të nivelit lokal, numri më i madh i ankesave në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishin ndaj vendimeve të Komunës së Prishtinës (6 ankesa), vendimeve të Komunës së Leposaviqit (4 ankesa), si dhe ndaj vendimeve të Komunës së Obiliqit (2 ankesa).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i ankesave të paraqitura ndaj institucioneve të administratës lokale gjatë periudhës janar – tetor 2021.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS LOKALE:	NUMRI I ANKESAVE PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS GJATË VITIT 2019:
Komuna e Prishtinës	6 ankesa
Komuna e Mitrovicës	1 ankesë
Komuna e Obiliqit	2 ankesa
Komuna e Gjilanit	1 ankesë
Komuna e Malishevës	1 ankesë
Komuna e Rahovecit	1 ankesë
Komuna e Leposaviqit	4 ankesa
Komuna e Lipjanit	1 ankesë
Komuna e Vushtrrisë	1 ankesë

Tabela 7.

Numri i ankesave të parashtruara në KPMSHC ndaj vendimeve të institucioneve të nivelit lokal gjatë periudhës janar – tetor 2021 për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

4.4 VENDIMET E KPMSHC-SË NË LIDHJE ME ANKESAT E PARASHTRUARA PËR NDËRPRERJE TË MARRËDHËNIEVE TË PUNËS

Duhet të theksohet se prej datës 21 janar 2019 deri në tetor të vitit 2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka qenë jofunksional, andaj gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë e mundur vendosja në lidhje me kërkesat e parashtruara. Kjo situatë ishte shkaktuar si pasojë e mos zgjedhjes së anëtarëve të KPMSHC-së nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.¹⁰


Konkretisht, me datë 19 dhjetor 2018 katër anëtarëve të KPMSHC-së ju ka skaduar mandati, ndërsa prej kësaj periudhe Këshilli ka vazhduar punën me një Kolegj prej tre anëtarëve. Ndërsa me 21 janar 2019, njëra anëtare është emëruar gjyqtare në sistemin e drejtësisë dhe rrjedhimisht KPMSHC ka mbetur pa kuorum për vendimmarrje dhe nuk ka mundur ta ushtrojë asnjë funksion të paraparë me dispozita ligjore.

[10] Për më tepër shih: https://kpmshc.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Draft%20Raporti%20i%20Pun%C3%ABs%20s%C3%ABKeshillit%20p%C3%ABr%20vitin%202019%2007.04.2020_compressed.pdf.

Mosfunksionimi i KPMSHC-së për gati dy vite ka shkaktuar vështirësi në mbrojtjen e të drejtave të shërbyesve civil të Kosovës, për shkak të pamundësisë së marrjes së vendimeve në njërën anë, dhe grumbullimit të numrit të madh të lëndëve, në anën tjetër.

Nga tetori 2020 deri në tetor 2021 (edhe gjatë kësaj periudhe, nga 30 qershor 2021 deri me 28 tetor 2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka qenë prapë jo funksional) për ndërprerje të marrëdhënies së punës janë vendosur 40 ankesa, prej të cilave 11 janë aprovuar, 3 janë hedhur poshtë, 22 janë refuzuar, 3 janë shpallur jo kompetente dhe 1 është kthyer në rishqyrtim.

Në grafikonin e mëposhtëm është paraqitur numri i vendimeve të aprovuara, të hedhura poshtë, të refuzuara, të shpallura jo-kompetente dhe të kthyera në rishqyrtim nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të shërbyesve civil .



Grafika 4.

Numri i vendimeve të marra nga KPMSHC gjatë periudhës tetor 2020 - tetor 2021, kur ky institucion ka qenë funksional.

Pra, duke marrë parasysh pamundësinë e zhvillimit funksional të këtij institucioni për një periudhe të gjatë kohore (për më shumë se dy vite), Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës prej vitit 2019 deri në tetor të vitit 2021 ka sjellë 40 vendime në lidhje me ankesat e shërbyesve civil për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

Bazuar në Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe duhet të zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të Këshillit.

Ndërkaq, moszbatimi i vendimit të këtij institucioni nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës. Si rezultati, në pajtim me dispozitat e ligjit, në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e plotë të vendimit të Këshillit.

5. KONTESTET GJYQËSORE NË LIDHJE ME MARRËDHËNIET E PUNËS GJATË PERIUDHËS JANAR- TETOR 2021


Bazuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi, ndaj vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm dhe i drejtë, mund të iniciojë konflikt administrativ nëpërmjet parashtrimit të padisë në gjykatën kompetente.

Në lidhje me këtë, gjatë periudhës janar – tetor 2021, nga Gjykatat e Republikës së Kosovës janë sjellë gjithsej 178 vendime për konteste pune, në rastet ku të paditura ishin institucionet shtetërore të përfaqësuara nga Avokatura Shtetërore.[11]

Nga të gjitha këto konteste, 109 konteste janë humbur nga institucionet shtetërore, që nënkupton se në këto raste janë anuluar vendimet për ndërprerje të marrëdhënieve të punës së të punësuarve në sektorin publik (që në këto konteste ishin në cilësinë e paditësit). Rrjedhimisht, gjykata i ka obliguar institucionet që paditësve t'ua bëj kompensimin e pagave dhe të shpenzimeve të tjera, si dhe kthimin e tyre në vendet e tyre të punës.

Në anën tjetër, numri i kontesteve të fituara nga institucionet shtetërore ishte 44, ndërsa 9 konteste janë aprovuar pjesërisht, 5 janë kthyer në rigjykim, 3 në rivendosje dhe për 1 rast padia është hedhur për shkak të jo kompetencës.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë grafike numri i vendimeve të humbura nga ana e institucioneve të Kosovës, numri i vendimeve të fituara nga ana e tyre, si dhe rastet tjera (raste të hedhura poshtë, të kthyera në rigjykim, rivendosje etj.).



Grafika 5.

Numri i vendimeve të fituara, të humbura dhe i rasteve të tjera, të sjella nga gjykatat e Republikës së Kosovës në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë periudhës janar – tetor 2021.

[11] Duhet të theksohet se Avokatura Shtetërore i përfaqëson të gjitha institucionet e nivelit qendror, ndërsa nga institucionet e nivelit lokal e përfaqëson vetëm Komunën e Glllogocit.

5.1 VLERA E FITUAR DHE VLERA E HUMBUR E INSTITUCIONEVE NGA KONTESTET GJYQËSORE

(TË PËRFUNDUARA ME EPILOG GJATË PERIUDHËS JANAR-TETOR 2021)


Vlera e humbur nga buxheti i shtetit në lidhje me vendimet gjyqësore të sjella gjatë periudhës janar -tetor 2021 për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe konteste të tjera lidhur me punën, [12] tejkalonte shumë 300 mijë euro (saktësisht 325,389.99 €).

Pra, kjo nënkupton se më shumë se 300 mijë euro i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës shkarkimet e paligjshme nga puna në institucionet publike (të cilat i përfaqëson Avokatura Shtetërore), si dhe vendimet e tjera në lidhje me punën në këto institucione brenda 10 muajve.

Kjo shumë e humbur tregon një barrë të rëndë për buxhetin e Republikës së Kosovës të shkaktuar nga vendimet e padrejta, që nuk bazohen në dispozita ligjore.

Ndërkaq në anën tjetër, 50 persona i kishin humbur kontestet e tyre, të iniciuara me padi për konteste të punës ndaj institucioneve publike në Gjykatat e Republikës së Kosovës gjatë këtij 10 mujori. Kjo ka rezultuar me më shumë se 120 mijë euro (saktësisht 120.300.11 €) të fituara nga ana e institucioneve të Republikës së Kosovës (që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore).

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur vlera e fituar dhe vlera e humbur nga buxheti i shtetit në lidhje me vendimet gjyqësore të shkarkimeve nga puna e të punësuarve në sektorin publik.



Grafika 6.

Vlera e fituar dhe vlera e humbur nga buxheti i shtetit nga kontestet për ndërprerje të marrëdhënies së punës gjatë periudhës janar – tetor 2021.

[12] Duhet të theksohet se në të dhënat e paraqitura në këtë kapitull, përveç shkarkimeve nga puna, përfshihen edhe kontestet e tjera në lidhje me punën, si kompensimi i dëmit, pagesa të pagave jubilarë etj..

5.2 INSTITUCIONET ME MË SË SHUMTI KONTESTE TË HUMBURA GJATË PERIUDHËS JANAR-TETOR 2021

Nga të gjitha vendimet e marra në periudhën janar -tetor 2021 nga Gjykatat e Republikës së Kosovës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, institucionet që kishin humbur më shumë konteste ishin: Komuna e Glllogocit, Agjensioni për Arsim dhe Aftësim Profesional, si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT).

- Institucioni me më së shumti konteste të humbura në periudhën janar - tetor 2021 në lidhje me kontestet e punës ishte Komuna e Glllogocit, me 65 konteste të humbura. Nga këto konteste, Komuna e Glllogocit kishte humbur mbi 90 mijë euro (saktësisht 91,428.90 Euro). Pra siç u sqarua edhe më lartë, Komuna e Glllogocit është komuna e vetme që përfaqësohet nga avokatët e Avokaturës Shtetërore.
- Institucioni i dytë me më së shumti konteste të humbura për marrëdhënie të punës ishte Agjensioni për Arsim dhe Aftësim Profesional, i cili kishte 13 konteste të humbura, me shumë totale mbi 14 mijë euro (saktësisht 14,039,64 Euro).
- Ndërkaq institucioni i tretë me më së shumti konteste të humbura në lidhje me punën ishte Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), me 11 konteste të humbura, shuma e të cilave ishte mbi 40 mijë euro (saktësisht 41,818.83 Euro).

Në tabelën e mëposhtme janë shfaqur tri institucionet (që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore) që më së shumti kanë humbur konteste gjatë periudhës janar-tetor 2021 në lidhje me marrëdhëniet e punës.

INSTITUCIONET	NUMRI I KONTESTEVE TË HUMBURA	SHUMA E PAGUAR PËR SHKAK TË KONTESTEVE TË HUMBURA
Komuna e Glllogocit / Kuvendi Komunal në Glllogoc	65	91,428.90 €
Agjensioni për Arsim dhe Aftësim Profesional	13	14,039.64 €
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)	11	41,818.83 €

Tabela 8.

Institucionet me më së shumti konteste të humbura në lidhje me marrëdhëniet e punës nga institucionet që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore në periudhën janar - tetor 2021.

5.3 INSTITUCIONET ME MË SË SHUMTI KONTESTE TË FITUARA GJATË PERIUDHËS JANAR-TETOR 2021

Nga të gjitha vendimet e marra në periudhën janar - tetor 2021 nga Gjykatat e Republikës së Kosovës në lidhje me kontestet e punës, institucionet që kishin fituar më shumë konteste ishin: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Komuna e Glllogocit / Kuvendi Komunal në Glllogoc, si dhe Policia e Kosovës.

- Institucioni me më së shumti konteste të punës të fituara në të gjitha vendimet e marra gjatë kësaj periudhe ishte Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila kishte 16 konteste të fituara, me shumë totale prej më shumë se 70 mijë euro (saktësisht 71,381.22 €).
- Institucioni i dytë me më së shumti konteste të fituara për marrëdhënie të punës gjatë kësaj periudhe ishte Komuna e Glllogocit / Kuvendi Komunal në Glllogoc, e cila kishte 14 konteste të fituara, me shumë totale prej më shumë se 28 mijë euro (saktësisht 28,261.06 Euro).
- Ndërkaq institucioni i tretë me më së shumti konteste të fituara ishte Policia e Kosovës, e cila kishte 9 konteste të fituara.

INSTITUCIONET	NUMRI I KONTESTEVE TË FITUARA	SHUMA E PRANUAR NGA KONTESTET E FITUARA
Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)	16	71,381.22 €
Komuna e Glllogocit/Kuvendi Komunal në Glllogoc	14	28,261.26 €
Policia e Kosovës	9	0.00 €

Tabela 9.

Institucionet me më së shumti konteste të fituara në lidhje me marrëdhëniet e punës nga institucionet që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore në periudhën janar -tetor 2021.

6. MUNGESA E DATABAZAVE PËR LARGIMET / SHKARKIMET E TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE (VËSHTIRËSITË PËR T'U INFORMUAR)

Për nevojat e përpilimit të këtij raporti, FOL i është drejtuar me kërkesa për qasje në dokumente publike institucioneve të ndryshme, ku ka kërkuar numrin e personave të larguar/shkarkuar nga puna në institucionet publike, numrin e padive të parashtruara në gjykata për shkak të vendimeve për shkarkime, si dhe shumat e fituara apo të humbura nga kontestet gjyqësore që kishin përfunduar me vendim të formës së prerë në lidhje me këto konteste.

Fillimisht, në lidhje me numrin e personave që iu është ndërprerë marrëdhënia e punës gjatë vitit 2019, 2020 dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021, FOL i është drejtuar **Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike**, por e njëjta është përgjigjur se ky institucion nuk ka të dhëna të tilla.

FOL më pas i është drejtuar **Ministrit të Drejtësisë/Avokaturës Shtetërore** në lidhje me numrin e kontesteve të punës që kanë përfunduar me epilog gjyqësor gjatë vitit 2019, 2020 dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021, të cilat janë përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore (në kontestet ndërmjet personave fizik si palë paditëse, dhe institucioneve shtetërore si palë e paditur), statusin e këtyre lëndëve dhe shumat e fituara dhe të humbura nga kontestet e përfunduara me vendime të formës së prerë. Ky institucion na ka ofruar të dhënat e kërkuara vetëm për periudhën janar - tetor 2021, ndërsa për dy vitet tjera na është përgjigjur se nuk kanë pasur databaza elektronike në lidhje me statuset e lëndëve, apo shumat e fituara dhe të humbura nga këto konteste. Ndërkaq përmbledhja e këtyre të dhënave, në mënyrë që të krijohen të dhëna për përgjigjen në kërkesën tonë për qasje në dokumente publike, “përbën përpjekje jo proporcionale, që shkon përtej një operimi të thjeshtë”, dhe si të tilla, sipas kësaj përgjigjeje, është e pamundur të përmbledhen nga ana e këtij institucioni.

FOL gjithashtu i është drejtuar me kërkesë për qasje edhe **Ministrit të Financave/Thesarit** në lidhje me shumat e paguara nga buxheti i shtetit për shkak të vendimeve të Gjykatave të Republikës së Kosovës në lidhje me vendimet për shkarkime nga puna, por e njëjta na është përgjigjur se nuk disponojnë të dhëna të tilla, dhe përmbledhja e të dhënave të tilla “përbën përpjekje jo-proportionale në kuptim të paragrafit 5.3 të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike”. Prandaj nuk ka qenë e mundur sigurimi i të dhënave të kërkuara për vitin 2019 dhe 2020 nga Ministria e Financave.

Meqenëse marrja e të dhënave përmes Kërkesave për Qasje në Dokumente Publike ishte e pamundur për periudhën tre vjeçare, atëherë FOL i është drejtuar të gjitha institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, organeve të pavarura dhe subjekteve të tjera shtetërore, veç e veç me Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike, që lidhen me numrin e të shkarkuarve / liruave nga marrëdhënia e punës në institucionet përkatëse, si dhe shumat e paguar/fituar nga kontestet gjyqësore të filluara me padi në gjykatë, ku personat fizik janë paraqitur në cilësinë e palës paditëse për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Nga kërkesat e dërguara 112 institucioneve të administratës qendrore, organeve të pavarura dhe subjekteve të tjera shtetërore, vetëm 59 prej tyre janë përgjigjur në kërkesat e dërguara. Nga përgjigjet e dërguara nga 59 institucionet thuhet se gjatë vitit 2019, 2020 dhe gjatë periudhës janar – tetor 2021, vetëm 7 institucione kanë pohuar se kanë pasur konteste aktive në lidhje me shkarkimin e punëtorëve nga puna, të iniciuara me padi nga ish të punësuarit në këto institucione.

Institucionet e administratës qendrore, organet e pavarura dhe subjektet e tjera shtetërore që kanë pohuar se kanë pasur konteste aktive në gjykata gjatë vitit 2019, 2020 dhe janar – tetor 2021, bazuar në përgjigjet e tyre në kërkesat për qasje në dokumente publike, duke i paraqitur të dhënat e klasifikuara mbi ato raste, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS QENDRORE, ORGANEVE TË PAVARURA DHE SUBJEKTEVE TË TJERA:	NUMRI I PADIVE TË PARASHTURARA:	NUMRI I VENDIMEVE TË SJELLURA:
MMPHI	2	2 vendime të fituara
MASHT	2	2 vendime të humbura
ARKEP	1	0 vendime
Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"	12	0 vendime
KEK	4	0 vendime
KOSTT	1	0 vendime
NH "Iber-Lepenc", Prishtinë	2	1 vendim i humbur

Tabela 10.

Institucionet e administratës qendrore, organet e pavarura dhe subjektet tjera shtetërore të paditura në lidhje me vendimet e tyre për shkarkimet / largimet nga puna të të punësuarve, bazuar në përgjigjet në kërkesat për qasje në dokumente publike të këtyre institucioneve.

Ndërkaq institucionet e tjera të administratës qendrore, që nuk janë paraqitur në tabelën e mësipërme, janë përgjigjur se nuk kanë pasur ndonjë padi të parashtruar në lidhje me vendimet e tyre për shkarkime të të punësuarve, apo nuk kanë kthyer fare përgjigjeje.

Ndërsa në kërkesat për qasje në dokumente publike të dërguara 38 Komunave të Kosovës, përgjigjeje kanë kthyer vetëm 23 komuna, dhe atë vetëm pas ankesës së bërë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi. Nga 23 përgjigjet e pranuar nga këto komuna, thuhet se gjatë kësaj periudhe (gjatë vitit 2019, 2020 dhe janar – tetor 2021) vetëm 3 komuna kanë pasur padi në lidhje me vendimet e marra për shkarkime nga puna.

Numri i institucioneve të administratës lokale që kanë pohuar se kanë pasur konteste aktive në gjykata gjatë vitit 2019, 2020 dhe janar – tetor 2021, bazuar në përgjigjet e tyre në kërkesat për qasje në dokumente publike, është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

INSTITUCIONET E PUSHTETIT LOKAL:	NUMRI I PADIVE TË PARASHTURARA	NUMRI I VENDIMEVE TË SJELLURA:
Komuna e Prizrenit	3 padi	0 vendime
Komuna e Rahovecit	48 padi ^[13]	6 vendime të fituara / 1 vendim i humbur nga ana e komunës
Komuna e Suharekës	2 padi	0 vendime

Tabela 11.

Institucionet e administratës lokale të paditura në lidhje me vendimet e tyre për shkarkimet / largimet nga puna të të punësuarve, bazuar në përgjigjet në kërkesat për qasje në dokumente publike të këtyre institucioneve

Ndërsa institucionet e tjera të pushtetit lokal, që nuk janë paraqitur në tabelën e mësipërme, janë përgjigjur se nuk kanë pasur ndonjë padi të parashtruar në lidhje me vendimet e tyre për shkarkime të të punësuarve, apo nuk kanë kthyer fare përgjigje.

Kërkimi i të dhënave për largimet dhe shkarkimet e të punësuarve ka qenë sfidë e natyrës së veçantë, duke kuptuar faktin se institucionet shtetërore asnjëherë nuk kishin mbajtur llogari, përkatësisht nuk disponojnë me databaza ku do të regjistronin të dhënat në lidhje me këtë çështje. Qytetarët e Republikës së Kosovës kërkojnë nga bartësit e institucioneve të mbajnë llogari mbi harxhimin e buxhetit të tyre, prandaj është e palogjikshme dhe e papranueshme mungesa e databazave për shënimin, përcjelljen dhe evidentimin e rasteve të aspekteve të ndryshme të punës ku do të reflektohej bilanci buxhetor i institucionit përkatës.

[13] Bazuar në përgjigjen në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike të Komunës së Rahovecit, këto konteste janë aktive që nga viti 2017.

7. REKOMANDIME

Nga të gjeturat e këtij raporti, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- Ndërprerja e marrëdhënies së punës së të punësuarve nga ana e punëdhënësve të bëhet kryekëput konform dispozitave të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës së Kosovës dhe të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të krijojë një databazë elektronike në të cilën do të regjistrohen të gjitha rastet e shkarkimeve, largimeve të punëtorëve (vullnetare) dhe kontesteve nga shërbimi civil në institucionet e pushtetit qendror dhe lokal.
- Rrjedhimisht, të detyrohen të gjitha institucionet e pushtetit qendror dhe lokal, si dhe organet tjera, të raportojnë të dhënat në databazën elektronike të MPBAP-së, në rastet e tilla, më së voni 1 muaj nga dita e shkarkimit, largimit, apo fillimit të kontestit.
- Gjykatat e Republikës së Kosovës t'i respektojnë afatet ligjore të trajtimit të lëndëve nga kontestet e punës si dhe rastet nga marrëdhëniet e punës t'i trajtojnë me prioritet.
- Të analizohen të gjitha rastet gjyqësore të kontesteve nga marrëdhënia e punës, ku si subjekte paraqiten institucionet shtetërore, në mënyrë që të nxjerrën konkluzione drejt përmirësimit të gjendjes në institucionet shtetërore.
- Ministria e Punëve të Brendshme dhe e Administratës Publike të ndërmarrë hapa konkret me qëllim të informimit dhe vetëdijesimit të institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve.
- Të rritet funksioni mbikëqyrës/monitorues i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës ndaj institucioneve të administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Rrjedhimisht, raportet në lidhje me të gjeturat e monitorimit të publikohen rregullisht në ueb-faqen e KPMSHC-së.

BURIMET

- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJI Nr. 03/L-149 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS , LIGJI NR. 06/L-048 PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS
- GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIGJI Nr. 04/L-157 PËR AVOKATURËN SHTETËRORE
- RAPORT I PUNËS SË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS PËR VITIN 2019
- RAPORT I PUNËS SË KËSHILLIT TË PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS PËR VITIN 2020
- PËRGJIGJET E INSTITUCIONEVE NË KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE